

10.03.2025

Ora 10:39

RENDI I DITËS

Shqyrtimi paraprakë i kërkesës ankimore nr.5 me subjekt ankues Partia MEGA

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** MEGA
- **Të tjerë:**

Z. L. Braho: Çelim seancën për shqyrtimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes për kërkesën ankimore nr.5 të depozituar me ankues Partia Minoritetit Etni Grek për të Ardhmen, MEGA. Personat e interesuar Kristaq Kiço, objekti i kërkesës është shfuqëzimi i vendimit i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.228 datë 03.03.2025 për rregjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë Mega me kryetar zotin Kristaq Kiço. Pika e dytë është rregjistrimi si subjekt zgjedhor i Partisë Mega me kryetar Lefter Nika. Bazë ligjore është ligji për partitë politike, Kushtetuta, Kodi i Procedurave Administrative. Është e plotë trupa e KAS me 5 anëtarë. Ju lutem na u prezantoni edhe ju për efekt procesverbali, pra kush është përfaqësuesi i ankuesit?

Z. Lefter Nika: Jam kryetari që dola nga gjykata e shkallës së parë dhe vazhdon procesi për rregjistrimin tonë të partisë. Por ngaqë nuk ishte i formës së prerë u detyruan të japin një vendim të pjesshëm.

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.03.2025*

Z. L. Braho: Përfaqësues me avokat? Është i pranishëm edhe zoti Petraq Dhimitri në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të ankuesit. Personi i interesuar Kristaq Kiço.

Z. Thoma Miço: Avokat, përfaqësues me prokurë.

Z. L. Braho: Dorëzoni prokurën. Ju keni ardhur me autorizim. Ky debati i vulave këtu tek ne nuk është i ri. Është e njëjta situatë me Partinë Demokratike që ju ishit referuar edhe në ankim. Se ideja është, këtu debati që bëni ju është, kush është kryetari sot që flasim dhe fakti kush është kryetari legjitimon pastaj kush është me autorizim dhe kush është me prokurë. Megjithatë meqenëse ju jeni këtu, nuk ka ndonjë problem. Mirë atëherë, për elementët e formës dhe të përmbatjes kisha uë më tepër, këtë e kam në formën e pyetjes sepse ose është problem skanimit ose nuk i keni sjellë ju të plota këto nuk e di. Pra, ju keni sjellë ankimin, është vendimi për rregjistrin e partive politike që është vendimi i datës 10 Shkurt 2025 i gjyqtarit Gentian Marku nuk është i plotë i mungon një faqe, është vendim për shqyrtimin e ankimit është beoj për disponim e ankimit. Që sipas jush është vendosur mos pranim i ankimit ndërkohë që këtu nuk e kemi. Është faqja e parë, kujtoja mos ishte para mbrapa. Ankimi ka ardhur dorazi këtu?

Av. Petraq Dhimitri përfaqësues i z. Lefter Nikës: Ankimin e kemi dorëzuar dorazi. Nuk ka marrë formë të prerë vendimi. Por që kanë qenë të plota, kanë qenë të plota.

Z. L. Braho: Të bëj një pyetje në bazë të vendimit për mos pranim ankimi ka nodhur ndonjë gjë procedurale?

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.03.2025*

Av. Petraq Dhimitri përfaqësues i z.Lefter Nikës: Sot është dita e pestë e ankimit, sot është afati i fundit.

Z. L. Braho: Sot është afati i fundit, në rregull. Keni bërë ankim ndaj kësaj, ankim të posaçëm? Mirë atëherë për elementët e formës dhe të përmbatjes, afati, kompetenca. Besoj me dy fjalë. Kur keni marrë dijëni për vendimin e Komisionerit.

Av. Petraq Dhimitri përfaqësues i z.Lefter Nikës: Është brenda afatit.

Z. L. Braho: Edhe diçka tjetër, pra ju keni ardhur tani si subjekt zgjedhor sepse është rregjistruar. Pavarësisht se kush do njihet kryetar kjo është një element tjetër por këtë do e doja nga të dyja palët. Keni mbledhur firma për të depozituar listë kandidatësh, keni pasur vullnetin për të qenë pjesë e një koalicioni dhe kjo mosmarëveshje ju ka prishur punë që të mos rregjistroheni në koalicion, pra flas për ju që pretendoni që të jeni kryetar.

Av. Petraq Dhimitri përfaqësues i z.Lefter Nikës: Në muajin Shtator janë bërë zgjedhjet brenda partisë e kemi çuar në gjykatë në datën 10 të muajit Shkurt është marrë vendimi nga gjykata për rregjistrimin e kryetarit të ri. Që në Shtator të vitit që shkoi kryetari i mëparshëm ose ai që është rregjistruar sot në KQZ nuk ka të drejtë të bëjë asnjë veprim normalisht. Tani e gjithë çështja është se gjyqtari i e vonoi 30 ditë arsyetimin e vendimit duke e vonuar arsyetimin jemi në fazën e shkeljes së afateve për në KQZ. Pra të gjitha ato, lista, koalicionet kanë qenë pasojë e vonesës. Në datën 3 gjyqtari sjell vendimin, atë vendimin për rregjistrim kishte bërë ankim pas dhënies së vendimit në 10 u dha vendimi në datën 18 kishtë bërë një ankim, kundër këtij vendimi ish kryetari i partisë që është rregjistruar por i ndryshuar për

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.03.2025*

shkak të zgjedhjeve. Gjykata vendos mos pranimin e ankimit po në datën 3 të këtij muaj. Në qoftë se Gjyqtari do ta kishte arsyetuar siç duhej arsyetuar vendimi i kësaj natyre nuk do ishte kjo problematikë as nga palët dhe besoj se nuk do të ishim as këtu. Kjo është ideja me dy fjalë. Tani dy pika kemi ne që kemi ardhur këtu, a legjitimohet kryetari i mëparshëm , a ka një procedurë të tillë, e dyta a kemi ne një pritshmëri nga e gjithë ky proces i thash po se kemi precedentin e më parshëm i cili ka vendimin e Gjykatës së Lartë për çështje analoge po pjesërisht të ngjashme. Mos pranimin e ankimit për subjektin për arsye që të mos i përmendim dhe e njëjta procedurë do ndiqet edhe nga Gjykata e Apelit për shkak të precedentit. Kjo është arsyeja pse ne jemi këtu, pastaj çështja e afateve pyetja që bëtë ju kandidatët lista, koalicionet kanë qenë pasojë se gjyqtari me datë 10 mori vendimin do të ishin arsyetuar në kohë të gjitha afatet nuk do të kishin skaduar. Do të ishte gjykuar do të kishim shkuar në apel do të kishim marrë vendimin e formës së prerë. Kjo është ideja e kësaj që po diskutojmë sot.

Z. L. Braho: Avokat edhe ju për interesin e ligjshëm, keni marrë kryetarin e keni ju, pra sot për KQZ kryetarin e keni ju. Keni mbledhur firma?

Z. Thoma Kiço përfaqësuesi i z. Kristaq Kiços: Është kryetari i partisë MEGA. Është rregjistruar brenda afatit ligjor, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka sjellë të gjithë dokumentacionin që kërkon ligji zgjedhor, Kodi Zgjedhor dhe është rregjistruar. Ankimimi i zotërinjëve ose Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ju la një afat 5 ditë që të plotësojnë dokumentacionin që do të jetë, vendimi i formës së prerë nga gjykata, që njihen këta si fraksion brenda partisë MEGA. Është një fraksion brenda partisë se ka kryer zgjedhje formale pa anëtarësinë e partisë dhe ka kërkuar

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.03.2025*

të rregjistrohet në gjykatë. Këto ishin në gjykim themeli në gjykatë ku ne kemi drejtuar një padi. Pra, nuk quhet një subjekt zgjedhor, fraksioni i partisë MEGA.

Z. L. Braho: Jo, subjekt zgjedhor është MEGA.

Z. Thoma Kiço përfaqësuesi i z.Kristaq Kiços: Është rregjistruar në rregjistrin e partive politike, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe si i tillë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk do të duhet ta kishte pranuar fare për rregjistrim se nuk quhet subjekt. Pra, duke mos qënë subjekt politik, nuk mund të bëhet subjekt zgjedhor të mos rregjistrohet në KQZ. Megjithatë i lanë 5 ditë afat dhe nuk e kanë paraqitur ende në kohë ose e kanë paraqitur dhe ne kemi bërë ankimim. Pra, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të rregjistruar si subjekt fraksionin e Partisë MEGA është i formës jo të prerë është ankimuar në Gjykatën e Apelit. Kështu që si i tillë....

Z. L. Braho: Ka pasur dy kërkesa për rregjistrim?

Znj. I. Osmanaj: Po kanë bërë dy kërkesa për rregjistrim, kërkesa nga zoti Kiço dhe nga zoti Lifter Nika.

Z. Thoma Kiço përfaqësuesi i z.Kristaq Kiços: E sollën rregjistrimin, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëri gabim që e pranoi. Jeni të rregjistruar në gjykatë nuk e keni të rregjistruar, kjo hapësirë që iu la është krijuar një precedent.

Z. L. Braho: Është krijuar precedenti këtu.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.03.2025*

Z. Thoma Kiço përfaqësuesi i z.Kristaq Kiços: E di që është krijuar precedenti, e kam studiuar, nj subjekt me dy kryetar.

Z. Ledio Braho: Thatë një moment që keni hapur një padi themeli?

Z. Thoma Kiço përfaqësuesi i z.Kristaq Kiços: Po, kemi bërë edhe për sigurimin e padisë. Siç tha edhe kolegu kemi dy muaj që e kemi....

Z. Ledio Braho: Pra, njëkohësisht është bërë ankimi për vendimin e rregjistrimit dhe padi për pavlefshmëri.

Z. Thoma Kiço përfaqësuesi i z.Kristaq Kiços:Kemi bërë kërkesë padi në themel, duke kërkuar edhe sigurinë e padisë. Zonja gjyqtare nuk e realizoi këtë, kemi ndërhyrë disa herë që realizoje këtë se nuk do ishim në këtë gjëndje tani, do ta ndante gjykata këtë punë se kush është ...

Z. L. Braho: Po për sigurimin e padisë ka vendim apo është rrezuar. Nuk ka marrë vendim nuk është shqyrtuar akoma. Në rregull.

Z. Thoma Kiço përfaqësuesi i z.Kristaq Kiços:Brenda 5 ditëve duhet ta bënin këtë gjë sepse ata dhe vajtën deri tek librii rregjistrimeve pa drejtësisht sepse tek libri i rregjistrimeve shkon një vendim i formës së prerë.

Z. L. Braho:Edhe një pyetje tjetër për efekt prove që do të merren në shqyrtim. Statuti i Partisë MEGA është njësoj siç ka qenë , përpara këtyre.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.10.03.2025

Z. Thoma Kiço përfaqësuesi i Kristaq Kiços: Statuti i Partisë MEGA është një lloj.

Z. L. Braho: Mund të na i paraqisni. Ne nuk kemi punë me fraksionin, nuk merremi me fraksionin thjesht statuti në qoftë se është e mundur të na i vini në dispozicion në cilësinë e provës kur të zhvillojmë seancën e shqyrtimit administrativ. Kush e ka nga ju? Dakord. Kanë ndonjë pyetje kolegët?

Z. E. Lako: Pse i referoheni si fraksion, fraksion në kuptimin e brendshëm apo gfraksion ligjor është një subjekt i ri?


Z. Thoma Kiço përfaqësuesi i z.Kristaq Kiços: Është i njëjti subjekt dhe ka një konflikt për sa i përket zgjedhjeve të brendshme të kësaj partie për sa i përket zgjedhjes së kryetarit, është i njëjti subjekt si parti.

Z. E. Lako: Ju pretendoni që ata nuk kanë një vendim të formës së prerë dhe tek rregjistri i partive figuroni ju si kryetar.

Av. Petraq Dhimitri përfaqësues i z.Lefter Nikës: Në datën 10 gjykata ka marrë vendim, ka marrë Gjykata e Lartë, kjo çështja e fraksioneve është koncept juridik, dhe nuk po merrem fare me këtë. Ka qenë në dijeni se çfarë është legjitimuar në atë proces do të thotë që ai vendimi është ai që është... Në datën 18 që gjykata kishte vendosur në këtë formë dhe kemi bërë aplikim në KQZ për subjekt zgjedhor. Në datë 24 shkojmë ne për të bërë aplikim nuk e dinim që kishte pasur një aplikim. Pra, partia është e regjistruar si subjekt, ytani çështja këtu është kush është kryetar.

Z. L. Braho: Partia një është. Nuk ka pretendime që ka dy MEGA.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.03.2025*

Z. E.Çefa: Një pyetje! Qëllimi final i juaj është që të konkuroni në zgjedhje apo jo secila palë? Tani jeni në kohë për të paraqitur listat eventualisht?

Z. L. Braho: Ose ju që keni pasur kryetarin keni tentuar që të bëni ndonjë marrëveshje?

Z. E.Çefa: Pra, ju MEGA pavarësisht se kush e drejton merrni dot pjesë në zgjedhje pra i plotësoni kriteret ligjore, keni deputet dhe nëse nuk keni deputet keni mbledhur firma? Pra, eventualisht si do që të ndahet kjo punë ju nuk merrni dot pjesë në zgjedhje?

Z. Thoma Kiço përfaqësuesi i z.Kristaq Kiços: Sido që të jetë ne nuk do të marrim pjesë në zgjedhje. Në momentin që u rregjistrua si subjekt politik u krijua kjo situata e amullisë dhe nuk kishim mundësinë as të negocionim për të qenë pjesë e një aleance.

Av. Petraq Dhimitri përfaqësues i z.Lefter Nikës: Tani e gjithë procedura jo se kishte ndonjë interes siç u pranua këtu, thjesht ti prishte punë kryetarit të ri. Po praktika gjyqësore ka avantazhe midis gjëndjes juridike dhe rregjistrimit të gjëndjes, sa do që të zgjasi kjo pjesë. Siç u pranua këtu nuk është se ka pasur interes të thotë që të thotë gjithë procedurën që normalisht duhet ta bëjë një subjekt që garon në zgjedhje. Qëllimi ka qenë që ti prishë punë kryetarit të ri të mos i bëj këto gjëra.

Z. L. Braho: Po kryetari i ri ndërkohë që ka qenë... pritshmëritë i ka pasur që do ishte subjekt zgjedhor ka mbledhur firma ose ka pasur tratativa për të hyrë në koalicion?

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.03.2025*

Av. Petraq Dhimitri përfaqësues i z.Lefter Nikës: Ne prisnim që të rregjistroheshim si subjekt zgjedhor.

Z. K. Bele: Do futeshit pjesë e ndonjë koalicioni?

Av. Petraq Dhimitri përfaqësues i z.Lefter Nikës: Të gjitha këto me kandidatë me koalicion, kjo është... vonesa e arsyetimit të Gjykatës na ka frenuar, ka qenë çështja teknike jo ligjore. Ligji dhe praktika e Gjykatës së Lartë e ka zgjidhur çështjen. Ne thjesht po diskutojmë pse gjyqtari e vonon 30 ditë vendimin e arsyetuar...

Z. L. Braho: Këtë nuk e zgjidhim dot.

Z. Lefter Nika: Partia ka pasur një koalicion me PS, dhe do të vazhdonim me deputetin e PS...

Z. L. Braho: Ky është deputet i PS?

Z. Lefter Nika: Është deputet i PS i cili është, ngaqë nuk ishte bërë në fillim koalicioni është i MEG-ës dhe vazhdon të jetë i MEG-ës në parlament.

Z. L. Braho: Është bërë ankimi për mos pranimin e ankimit, ankimi i posaçëm të na i sillni edhe atë.

Z. Thoma Kiço përfaqësuesi i z.Kristaq Kiços: Është bërë me 07.03.2025.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.10.03.2025*

Z. L. Braho: Të Premtën, bëj një fotokopje asaj. Atëherë, KAS i konsultuar në vend vendosi që ta kalojë për shqyrtim administrative kërkesën ankimore nr. 5 të datës 06.03.2025 me ankues Partinë MEGA. Seanca e shqyrtimit administrative do të zhvillohet sot me dt.10.03.2025 ora 11:45

Vendimi nr. 13

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

